

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për ta administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

## KONKURS PUBLIK (RISHPALLJE)

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikur në vijim:

### Titulli i pozitës:

**ZYRTAR I SIGURISË SË INFORMACIONIT**

Orët e punës:

Jo më shumë se 120 ditë në vit

Numri i referencës:

**KON012025 (R)**

Kohëzgjatja e emërimit:

Kontratë për punë dhe detyra specifike

Adresa:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari i Sigurisë së Informacionit është përgjegjës për monitorimin, konfigurimin dhe përmirësimin e masave të sigurisë në rrjet dhe sistemet e FKPK-së. Qëllimi kryesor është mbrojtja e të dhënave të ndjeshme dhe siguria e vazhdueshme ndaj kërcënimeve kibernetike. Detyrat përfshijnë:

- Monitorimi dhe konfigurimi i sistemeve të sigurisë
- Menaxhimi i cënueshmërive
- Rishikimi i dobësive dhe incidenteve
- Testimi dhe përmirësimi i sigurisë
- Qeverisja dhe menaxhimi i sigurisë së informacionit
- Programi i vetëdijesimit për sigurinë e informacionit
- Mbështetja për vazhdimësinë e biznesit
- Menaxhimi i rrezikut dhe mbrojtja e të dhënave.

Në linkun në vijim prezantohen detajet e detyrave dhe përgjegjësi: [Specifikimet teknike për zyrtar të sigurisë së informacionit](#)

### Kandidati ideal do të ketë:

- Njohuri të thella për skanimin e dobësive, monitorimin e sigurisë dhe menaxhimin e incidenteve.
- Aftësi të mira në analizimin dhe vlerësimin e rrezikut dhe incidentet e sigurisë.
- Aftësi të shkëlqyera për komunikim, bashkëpunim dhe raportim të qartë.

### Kriteret:

**Edukimi:**

Diplomë universitare (baçelor) në shkenca kompjuterike ose TIK.  
Certifikime të vlefshme si CompTIA Security+, CEH, CISSP, CySA+ ose ekuivalente.

**Përvoja:**

Përvojë minimale prej dy vjetësh në sigurinë e informacionit ose një rol të ngjashëm.

**Referenca:**

Së paku dy (2) referenca që dëshmojnë angazhimin/përvojën përkatëse profesionale.

### Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur prej **31 janarit e deri më 20 shkurt 2025 në 23:59 (CET)**.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: [recruitment@trusti.org](mailto:recruitment@trusti.org), me referencë: "Zyrtar i Sigurisë së Informacionit"
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim: Diploma, biografia (CV), letërmotivimi dhe certifikatat profesionale në fushën përkatëse (nëse ka).

### Informim paraprak:

- Aplikacionet që nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet e lartcekura NUK do të shqyrtohen! Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit do të kontaktohen.
- Kandidatët mund t'i nënshtrohen testimit për vlerësimin e aftësive të kërkuara.

**FKPK-ja është punëdhënës që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!**